



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.09.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 14:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Brikena Ukperaj, z. Dritan Hallunaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Ashtu siç edhe u lajmërua në përfundim të mbledhjes plenare të mëparshme, seanca e radhës e orës 14:00, e cila drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit, ka për objekt caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të emergjencës dhe natyrës së çështjes së paraqitur nga Gjykata e Apelit Gjirokastër është përgatitur relacioni përkatës në lidhje me plotësimin e trupit gjykues. Kërkesa duhet të gjykohet nga gjykata brenda afateve shumë të kufizuara kohore.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, duke përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Genti Dokollari.

Me përfundimin e procedurës së hedhjes së shortit, përfundon dhe trajtimi i relacionit të përgatitur nga Komisioni. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor